



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:249750

Datë: 24.12.2024

Numri i dokumentit: 06644544

C.nr.2698/2024

GJYKATA THEMELORE MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Blerim Istrefi, në çështjen juridike kontestimore të paditësve N.I., V.S., L.Ç., M.P.dhe Xh.M., që të gjithë nga Mitrovica, të cilin e përfaqëson Leutrim Ademi av në Mitrovicë, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës Drejtoria Komunale e Arsimit, baza e kontestit: Kompensimin inflacionit në pagë, jashtë seance gjyqësore me datë 24.12.2024, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M
për shkak të pa dëgjueshmërisë – mosbindjes

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësve N.I., V.S., L.Ç., M.P.dhe Xh.M., që të gjithë nga Mitrovica, **DETYROHET** e paditura Komuna e Mitrovicës Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve, në emër të kompensimit të inflacionit në page për periudhën kohore Janar 2021 deri me 22.11.2022 si në vijim;

- Paditësit N.I. në shumën prej 766.38 euro
- Paditësit V.S. në shumën prej 437.64 euro.
- Paditëses L.Ç në shumën prej 737.96 euro.
- Paditëses M.P. në shumën prej 700.28 euro
- Paditëses Xh.M. në shumën prej 774.44 euro

Për secilin veç e veç me kamat ligjore prej 8 % nga data 22.07.2024, deri në pagesën definitive të detyrimit, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Mitrovicës Drejtoria Komunale e Arsimit, t'ia paguaj paditëses shpenzimet e procedurale në shumë të përgjithshme prej 332.00 €, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësit, përmes te autorizuarit me padi të datës 22.07.2024, ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Mitrovicës Jugore- Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve, në emër të kompensimit të inflacionit në pagë për periudhën Janar 2021 deri me Nëntor 2022 dhe atë për paditësit N.I. në shumën prej 766.38 euro ,paditësit V.S. në shumën prej 437.64 euro, paditëses L.Ç në shumën prej 737.96 euro, paditëses M.P. në shumën prej 700.28 euro, paditëses Xh.M. në shumën prej 774.44 euro, konform nenin 35 të Kontratës Kolektive te Arsimit nr. 01/13, 105 te datës 22.01.2021 me kamat ligjore prej 8 % nga data e parashtrimit të padisë, deri në pagesën definitive të detyrimit, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore pas shqyrtimit paraprak të padisë ka nxjerrë aktvendimin për përgjigje në padi me datë 11.11.2024, të cilin e paditura e ka pranuar me dt.19.11.2024 (e cila është konfirmuar përmes fletë kthesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës). Me aktvendimin për përgjigje në padi, gjykata e ka njoftuar të paditurën për detyrimin ligjor për dhënie të përgjegjës në padi dhe për pasojat ligjore që do t'i ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, gjegjësisht për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes - pa dëgjueshmërisë.

E paditura, pavarësisht se e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat materiale në këtë çështje juridike kontestuese, nuk ka paraqitur përgjigje në padi brenda afatit ligjor.

Gjykata, pasi i ka vlerësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mosbindjes, ka gjetur së në rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit në fjalë nga neni 150 paragrafi 1 pikat a), b) dhe (c) të LPK-së, nëse të paditurit i është dorëzuar padia dhe thirrja për përgjigje në padi, se themelësia e kërkesëpadiës del nga faktet e treguara në padi dhe se faktet në të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vetë paditësi apo me faktet e ditura botërisht.

Themelësia e kërkesëpadiës del nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, dhe atë:

Nga lista e pagës lëshuara nga BRK me datën 01. Maj 2021 vërtetohet se paditësi N. I. ka të ardhura neto në shumën prej 480.20 euro, e po ashtu nga kërkesa e dt. 14.06.2024 nuk ishte kontestuese fakti se i njëjti është i punësuar tek e paditura.

Nga lista e pagës e lëshuara nga BRK me datën 01. Maj 2021 vërtetohet se paditësi V.S. ka të ardhura neto në shumën prej 437.19 euro, e po ashtu nga kërkesa e dt. 14.06.2024 nuk ishte kontestuese fakti se e njëjta është e punësuar tek e paditura.

Nga lista e pagës e lëshuara nga BRK me datën 01. Maj 2021 vërtetohet se paditësja L.Ç ka të ardhura neto në shumën prej 437.19 euro, e po ashtu nga kërkesa e dt. 14.06.2024 nuk ishte kontestuese fakti se e njëjta është e punësuar tek e paditura.

Nga lista e pagës e lëshuara nga BRK me datën 01. Maj 2021 vërtetohet se paditësja M.P. ka të ardhura neto në shumën prej 437.19 euro, e po ashtu nga kërkesa e dt. 14.06.2024 nuk ishte kontestuese fakti se e njëjta është e punësuar tek e paditura.

Nga lista e pagës e lëshuara nga BRK me datën 01. Maj 2021 vërtetohet se paditësja Xh.M. ka të ardhura neto në shumën prej 437.19 euro, e po ashtu nga kërkesa e dt. 14.06.2024 nuk ishte kontestuese fakti se e njëjta është e punësuar tek e paditura.

Ndërsa nga indeksi i harmonizuar çmimeve të konsumit konstatohen ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në përqindje: inflacioni për vitin 2021 është 3.4%, ndërsa për vitin 2022 është 11.6%.

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së dhe Mendimit Juridike të Gjykatës Supreme të Kosovës për kamatën nr.265/2020 të datës 01.12.2020, ka marr datën e ushtrimit të padisë (data 22.07.2024), e ku lartësia e kamatës vjetor është e definuar 8% deri në pagesën definitive.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së, lartësia e shpenzimeve i referohet 312 € për përpilim padisë si dhe 20 € në emër të taksës gjyqësore për padi.

Gjykata, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke i'u referuar dispozitës së nenit 150 par.1 pika a, b, dhe c të LPK-së, e në lidhje me dispozitat e nenit 17 par.3 nën par 3.1 dhe par 4 të Kontratës Kolektive të Arsimit të vitit 2021, dhe dispozitave të nenit 245 par.1 dhe 2, neni 249 par.1 dhe 2 të LMD-së.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.2698/2024 dt.24.12.2024

Gjyqtari
Blerim Istrefi

Udhëzim juridik: Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.